



POZITË DHE OPOZITË JANË TË MENDIMIT SE VENDI MUND TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE

FAQE 4-5



Fundi i vitit 2024 ose fillimi i vitit 2025 do të jetë vit i zgjedhjeve të rregullta parlamentare në Kosovë. Por fillimi i këtij viti ka

shtuar zërat nga opozita dhe nga pushteti për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Edhe

përfaqësuesit e pozitës nuk e kanë përjashtuar mundësinë të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare

BE-ja PO PUNON PËR TA KUSHTËZUAR ANËTARËSIMIN E SERBISË ME ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE ME KOSOVËN F. 6



"PAGA TË VOGLA", MËSUESIT SHFRYTËZOJNË PUSHIMET PA PAGESË PËR EMIGRIM F. 3



PSE PO PROTESTOJNË BUJOIT NË GJERMANI? F. 8

SPORT



GAZETA KROATE I THUR LAVDE HOXHËS: ËSHTË PROFESIONIST, LUFTËTAR, DINAMO NUK KA PREJ KOHËSH NJË SI AI F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Scholz u bënë thirrje vendeve të BE-së ta rritin furnizimin me armë për Ukrainën

BERLIN, 9 JANAR - Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, u ka bërë thirrje vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) t'i japin më shumë mbështetje ushtarake Ukrainës gjatë këtij viti, e cila është duke e luftuar pushtimin rus. Scholz i bëri këto thirrje gjatë një konference për shtyp me kryeministrin e Luksemburgut, Luc Friedman, më 8 janar në Berlin. "Dërgesat e armëve për Ukrainën, të planifikuara nga shumica e vendeve anëtare të BE-së tani, janë shumë të vogla... unë u bëj thirrje aleatëve tanë në Bashkimin

Evropian që t'i rritin përpjekjet e tyre për Ukrainën", tha Scholz. Gjermania është mbështetësja e dytë më e madhe ushtarake e Ukrainës, pas Shteteve të Bashkuara. Ukraina ka paralajmëruar që lufta dhe financat e saj publike do të jenë në rrezik të madh nëse do të ndalen ndihmat prej Perëndimit. Ukraina ka regjistruar ndryshim të vogël të linjës së kontrollit, pas nisjes së kundërofensivës pranverore, dhe tani po përballet me një rënie graduale të ndihmave

prej aleatëve në Uashington dhe Evropë. Ndërkohë, Rusia është duke i vazhduar sulmet mbi Ukrainë. Më 8 janar ushtria ruse i sulmoi rajonet e Ukrainës me një breshëri raketash, duke i vrarë së paku katër persona, plagosur mbi 40 të tjerë, si dhe duke shkaktuar dëme në infrastrukturën civile dhe objektet ekonomike, thanë zyrtarët ukrainas. Ushtria ukrainase tha se në shumicën e vendit, përfshirë në kryeqytetin Kiev, u lëshuan sirena për sulme ajrore më 8 janar.



Blinken: Udhëheqësit e Lindjes së Mesme, të vendosur për pengimin e përhapjes së luftës

AL ULA, 9 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se udhëheqësit në Lindjen e Mesme janë të vendosur për ta penguar përhapjen e konfliktit të Gazës dhe se ekziston një pajtueshmëri mbi nevojën për të "hartuar një rrugë politike përpara për palestinezët". "Bregu Perëndimor dhe Gaza duhet të bashkohen nën qeverisjen e udhëhequr nga palestinezët", u tha Blinken gazetarëve në aeroportin Al Ula në Arabinë Saudite. "E ardhmja e rajonit duhet të jetë integrimi, jo ndarja dhe konflikti", tha Blinken, duke shtuar se "për ta realizuar këtë, ne duhet ta shohim krijimin e një shteti të pavarur palestinez". Në një deklaratë pas bisedimeve me sekretarin Blinken, Princi i Kurorës së Arabisë Saudite Mohammed bin Salman nënvizoi rëndësinë e ndalimit të operacioneve ushtarake në Rripin e Gazës dhe nevojën për të krijuar kushte për rivendosjen e paqes dhe stabilitetit. Mediet lokale kanë raportuar se kjo përpjekje synon të sigurojë që populli palestinez të marrë të drejtat e tij legjitime dhe të arrijë



një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Arabia Saudite ka ndërprerë bisedimet diplomatike për t'i normalizuar marrëdhëniet me Izraelin për shkak të konfliktit ushtarak midis militantëve të Hamasit dhe forcave izraelite. Të hënën Blinken u takua me presidentin e Emirateve të Bashkuara Arabe Sheikh Mohammed bin Zayed Al

Nahyan dhe zyrtarë të lartë nga Arabia Saudite përpara se të shkonte në Izrael. Kryediplomati amerikan tha se do t'u kërkojë zyrtarëve izraelitë që të krijojnë më shumë hapësirë për dërgimin e ndihmave humanitare në Rripin e Gazës dhe të bëjnë më shumë për mbrojtjen e civilëve. Blinken tha se katër vende arabe dhe Turqia kanë rënë dakord ta

fillojnë planifikimin për rindërtimin pas konfliktit dhe qeverisjen e Gazës sapo të përfundojë lufta e Izraelit kundër Hamasit. Në një mision urgjent në Lindjen e Mesme që synon kryesisht frenimin e përhapjes së konfliktit në një luftë rajonale, Blinken tha të hënën se Arabia Saudite, Jordania, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Turqia do të

konsideronin pjesëmarrjen dhe kontributin për të rindërtuar pas luftës Rripin e Gazës, i cili është shkatërruar nga bombardimet izraelite në tre muajt e fundit. Këto vende u kishin rezistuar më parë thirrjeve të Shteteve të Bashkuara për fillimin e planifikimit të pasluftës, duke këmbëngulur se së pari duhet të ketë një armëpushim dhe pakësim të vuajtjeve të civilëve, të shkaktuar nga ofensiva ushtarake e Izraelit në përgjigje të sulmit vdekjeprurës të Hamasit në Izrael më 7 tetor. Në turneun e tij të fundit në Lindjen e Mesme, i katërti që nga fillimi i luftës në tetor, Blinken tha se ato vende tani janë të hapura për një planifikim të tillë dhe se secili do ta konsideronte përfshirjen e tij në atë që do të vendoset përfundimisht. "Ne ramë dakord të punojmë së bashku dhe t'i koordinojmë përpjekjet tona për të ndihmuar në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e Gazës, për të hartuar një rrugë politike përpara për palestinezët dhe për të punuar drejt paqes, sigurisë dhe stabilitetit afatgjatë në rajon në tërësi", u tha Blinken gazetarëve.

Gabriel Attal bëhet kryeministri më i ri në historinë moderne të Francës

PARIS, 9 JANAR - Emmanuel Macroni e ka emëruar Gabriel Attalin kryeministër të ardhshëm të Francës në përpjekje për ta ringjallur Presidencën e vet me një qeveri të re. Si 34-vjeçar, Attal bëhet kryeministri më i ri në moshë në historinë moderne të Francës, duke e tejkaluar madje edhe socialistin Laurent Fabius, i cili ishte 37 vjeç kur u emërua nga

François Mitterrand më 1984. Attali e zëvendëson Elisabeth Bironen, e cila dha dorëheqje pas vetëm 20 muajve në detyrë. Gjatë qëndrimit në pushtet ajo hasi në vështirësi për shkak të mungesës së shumicës në parlament. Gabriel Attal, i cili aktualisht është ministër i Arsimit, ka marrë vëmendje të madhe pas emërimit. Tani detyra e tij do të

jetë ta udhëheqë Qeverinë e Francës para zgjedhjeve të rëndësishme të Parlamentit Evropian në qershor. Rritja e tij ka qenë e shpejtë. Para dhjetë vjetëve ai ishte këshilltar në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe anëtar i Partisë Socialiste. Ai do të jetë homoseksuali i parë i deklaruar që do ta zërrë zyrën e kryeministrit të Francës, Matignon.



Në 2023-n në Klinikën e Pediatriisë mbi 7 000 fëmijë ishin të shtrirë për trajtim mjekësor

Prishtinë, 9 janar - Klinika e Pediatriisë, e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), mbetet një nga klinikat më të ngarkuar me pacientë. Sipas raportit vjetor të punës së Klinikës së Pediatriisë për vitin 2023, gjatë një viti në këtë klinikë kanë qenë të shtrirë 7 141 fëmijë për trajtim mjekësor në reparte të ndryshme të kësaj klinike, me gjithsej 51 470 ditë shërimi. Po sipas të njëjtit raport, ka pasur gjithsej 21 256 vizita ambulatore.



BE-ja po punon për ta kushtëzuar anëtarësimin e Serbisë me zbatimin e marrëveshjeve me Kosovën

PRISHTINË, 9 JANAR - Komisioni Evropian dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm i BE-së (EEAS) janë duke punuar për ta ndryshuar kornizën e bisedimeve me Serbinë për anëtarësimin e saj në Bashkim Evropian (BE), në mënyrë që në mesin e kushteve detyruese ta vendosin edhe zbatimin e marrëveshjeve që ajo i ka arritur deri tani me Kosovën në dialogun e ndërmjetësuar nga ajo. “Puna në këtë drejtim po vazhdon në përputhje me kërkesën e vendeve anëtare”, tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, të martën në një konferencë për shtyp në Bruksel. Kërkesa për ndryshimin formal të kushteve në kapitullin 35 u bë nga shtetet anëtare të BE-së në konkluzionet e miratuara nga Këshilli për Çështje të Përgjithshme në dhjetor. Që nga viti 2011 BE-ja e ndërmjetëson dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Ky proces mbështetet edhe nga Shtetet e Bashkuara. Vitin e kaluar palët arritën Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve



dhe Aneksin për zbatimin e saj. Pavarësisht prej trysnisë ndërkombëtare që palët ta zbatojnë marrëveshjen, blloku evropian ka thënë se ajo nuk po zbatohet. Pikërisht përfshirja e detyrimit për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën në kornizën e bisedimeve për anëtarësim në BE ishte përmendur nga zyrtarët e lartë të

bllokut si mënyrë që marrëveshja e arritur në Bruksel më 27 shkurt dhe më pas më 18 mars në Ohër, aneksi për zbatimin e saj, të bëhen “ligjërish të detyrueshme”. BE insiston se, sipas Konventës së Vjenës, edhe marrëveshjet që janë rezultat i pajtimit e që nuk janë nënshkruar kanë fuqinë e obligimit ligjor për palët. Dhe kjo, sipas BE-së, vlen edhe për marrëveshjen e vitit të kaluar për normalizimin e marrëdhënieve. Por, një letër e kryeministres së Serbisë, Ana Bernabiq, në të cilën ajo konfirmoi në dhjetor se ka vija të kuqe kur është fjala për zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën, paraqet herën e parë që ky shtet me shkrim deklaroi se nuk do t'i zbatojë disa nene të kësaj marrëveshjeje. Ditë më parë presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq tha se Evropa po i kërkon Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës. “De facto ose de jure, kjo po kërkohet. Le të mos gënjejmë për këtë gjë. Fuqia më e madhe, Bashkimi Evropian, po e kërkon këtë”, tha Vuçiqi për televizionin Pink më 7 janar.

Kosova nënshkruan marrëveshje me Arabinë Saudite për lirim reciprok nga vizat të atyre që kanë pasaporta diplomatike dhe zyrtare



PRISHTINË, 9 JANAR - Të martën në Riad, zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, u prit nga zëvendësministri për Punë të Jashtme i Arabisë Saudite, Waleed Abdulkarim El Kherei. Gjatë takimit me zëvendësministër për Punë të Jashtme, El Kherei, u bisedua për ngritjen e bashkëpunimit ekonomik, bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe kundër terrorizmit dhe për nisjen dhe finalizimin e marrëveshjeve në fushën e transportit, edukimit dhe sportit.

Duke vlerësuar lart bashkëpunimin në mes të dy shteteve, zëvendësministri Ahmeti ka falënderuar Arabinë Saudite për përkrahjen dhe kontributin e vazhdueshëm për Republikën e Kosovës. Ahmeti kërkoi që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë procedura më të lehta për hyrje në Arabinë Saudite. Takimi u përmbyll me nënshkrimin e marrëveshjes për heqjen reciproke të vizave për bartësit e pasaportave diplomatike dhe pasaportave zyrtare.

Jeton Raka emërohet zëvendësministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Prishtinë, 9 janar - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar të martën Jeton Rakën, Hapësinor dhe detyrën dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësi të reja.





Pozitë dhe opozitë janë të mendimit se vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare

Fundi i vitit 2024 ose fillimi i vitit 2025 do të jetë vit i zgjedhjeve të rregullta parlamentare në Kosovë. Por fillimi i këtij viti ka shtuar zërat nga opozita dhe nga pushteti për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Edhe përfaqësuesit e pozitës nuk e kanë përjashtuar mundësinë të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 JANAR - Fundi i vitit 2024 ose fillimi i vitit 2025 do të jetë vit i zgjedhjeve të rregullta parlamentare në Kosovë. Albin Kurti ka marrë mandatin qeverisës më 22 mars të vitit 2021. Pra, Kuvendi i Kosovës është konstituuar më 22 mars 2021 dhe mandati fillon nga dita e konstituimit, që do të thotë mandati i kësaj legislature përfundon më 22 mars 2025. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zgjedhjet e rregullta parlamentare nuk mbahen më herët se 60 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit. Duke iu referuar këtij ligji, sipas kompetencave të presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, shefi i shtetit cakton datën e zgjedhjeve jo më herët se gjashtë muaj dhe jo më vonë se katër muaj para datës

së zgjedhjeve.

Njohësi i proceseve politike në vend, Burim Ramadani, ka theksuar se zgjedhjet parlamentare para 26 janarit 2025 janë vetëm zgjedhje të parakohshme. Ai ka thënë se shpallja e zgjedhjeve të rregullta parlamentare mund të bëhet midis 6 deri në 4 muaj para datës së zgjedhjeve. “Nëse zgjedhjet do të mbaheshin më 26 janar 2025, atëherë shpallja zyrtare nga presidentja mund të bëhet midis 26 korrikut dhe 26 shtatorit 2024”, ka thënë ai.

Në fillim të këtij viti janë shtuar zërat nga opozita dhe nga pushteti për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, por edhe shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari, kanë shpalosur argumentet e tyre pse zgjedhjet mund të mbahen

gjatë këtij viti. “Është mirë që të shkohet në zgjedhje të parakohshme. Nuk mund ta përjashtoj mundësinë për zgjedhje të parakohshme”, ka deklaruar Konjufca për mediet në Kosovë.

Ai ka thënë se për shkak të shumë zhvillimeve do të ishte mirë që qeveria e re që do të marrë legjitimitetin e popullit të përfundojë disa procese që po kalon Kosova.

Derisa shefja e deputetëve të LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se viti 2024 është vit i dinamikave të shumta në botë dhe, si të tillë, ajo e sheh që mund të ketë ndikim edhe në Kosovë.

Ajo thotë se nuk do të ishte diçka e paarsyeshme nëse zgjedhjet e rregullta mbahen në fund të këtij viti. “Sipas kalendarit zgjedhor, ka mundësi që deri në fund të vitit të organizojmë zgjedhje të rregullta të cilat do të jenë në përputhje me kalendarin zgjedhor, i cili në të kundërtën do të ishte në shkurt të vitit 2025. Por, para dhe pas në periudhën 60 ditore ka mundësi të diskutimit ndërmjet subjekteve politike me presidenten e vendit për të gjetur një datë të përbashkët. Prandaj, nuk do të ishte risi nëse Kosova do të ballafaqohet me proces zgjedhor këtë vit. Pra, nuk do të

ishte krejtësisht e jashtëzakonshme”, ka deklaruar ajo.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, është i bindur se viti 2024 do të jetë vit zgjedhor në Kosovë. Ai thotë se bota nuk mund ta presë Albin Kurtin në lidhje me taktizimet që ky i fundit i bën me procesin e dialogut. “Po shihet tashmë edhe nga deklaratimet dhe veprimet e qeverisë dhe kryeministrit Kurti, nga tubimet e karakterit elektoral, por edhe nga forma aspak korrekte dhe e drejtë e shpenzimit të buxhetit të shtetit në raport me subvencionimet e ndryshme që i kanë bërë dhe që i kanë planifikuar. Besoj se në vitin 2024 gjithsesi do të kemi zgjedhje të parakohshme, por nuk mund të them me siguri se a do të mbahen ato në qershor, në tetor më herët apo më vonë”, ka deklaruar Krasniqi.

Edhe nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka shprehur gatishmërinë për zgjedhje të parakohshme, duke theksuar se LDK-ja ka çdo kapacitet njerëzor, politik dhe ekspertizë të nevojshme, duke përfshirë një program politik të operacionalizuar dhe buxhetuar. “Zgjedhjet e parakohshme të cilat i shkurtojnë mandatin z. Kurti

vetëm për katër muaj nuk mund të quhen zgjedhje të parakohshme. Të parakohshme mund të quhen vetëm ato zgjedhje të cilat mbahen deri në qershor. Por, edhe nëse dëshirojnë t'i mbajnë në muajin gusht, zgjedhjet janë të mirëseardhura. Në atë muaj mërgimtarët janë këtu, dhe mund ta shprehin lirshëm vullnetin e tyre pa pasur nevojë të shpenzohen dy herë”, është shprehur Haziri.


Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se viti 2024 është vit zgjedhor për shkak se edhe për zgjedhjet e rregullta ato duhet të shpallen më herët se gjashtë muaj, më së voni katër muaj para zgjedhjeve. “Kjo nënkupton që partitë politike do të punojnë për përpilimin e listave të zgjedhjeve. Problem nuk është përcaktimi i zgjedhjeve të parakohshme apo të rregullta. Problem është që kjo qeveri është duke i shkaktuar dëme të mëdha Kosovës dhe është duke e dëmtuar. Në veçanti, në varfërimin dhe në ekonominë e Kosovës, e cila është në rrafshin më të ulët në historinë e vet. Andaj, sa më shpejt që shkon kjo qeveri, aq më mirë do të jetë për Kosovën dhe për qytetarët e saj”, ka thënë Tahiri.

633 raste të shkeljes së pushimit vjetor të punëtorëve gjatë vitit 2022

PRISHTINË, 9 JANAR - Organizata Çohu ka publikuar një hulumtim për problemet më të shpeshta të punëtorëve në sektorin privat, duke përfshirë këtu pushimet të cilat parashihen me ligj, mospagesë për oraret shtesë, jashtë orarit të punës dhe festave, të cilat u jepen me vështirësi punëtorëve në Kosovë. Sipas këtij raporti, thuhet se shkeljet te pushimet vjetore sipas Inspektoratit të Punës janë: Në vitin 2020 gjithsej 110

raste, në vitin 2021, 332 raste dhe në vitin 2022 ne total 633 raste. Raporti ka hulumtuar edhe çështjen e pagesës së pushimit vjetor të punëtorëve. 80 për qind të punëtorëve u është paguar pushimi vjetor, ndërsa 20 për qind nuk u është kompensuar. Derisa sa i përket pushimit të lehonisë për gratë, thuhet se 49.43 për qind e grave nuk kanë kërkuar nga punëdhënësi shfrytëzimin e pushimit të lehonisë dhe 50.57 për qind e

kanë kërkuar këtë të drejtë. Prej këtyre, 49.44 për qind nuk u është dhënë pushimi nga punëdhënësi dhe 50.56 për qind u është dhënë ky pushim. Ky raport ka trajtuar edhe çështjen e kompensimit të pagës sipas Ligjit për Pushimin e Lehonisë. 77.44 për qind e grave u është bërë kompensimi i pagës dhe 26.67 për qind të grave nuk u është bërë kompensimi. E për këtë thuhet se e vetmja zgjidhje është ndryshimi i Ligjit të Punës dhe zbatimi i tij.



IPK-ja jep gjashtë rekomandime për menaxhimin e trafikut rrugor në kryeqytet



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
PRISHTINË, 9 JANAR - Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) të hënë ka publikuar raportin e inspektimit lidhur me menaxhimin e trafikut rrugor në kryeqytet. Në raportin e publikuar, IPK-ja ka dhënë gjashtë rekomandime lidhur me menaxhimin e trafikut rrugor në

kryeqytet. Sipas IKP-së, gjetjet e këtij inspektimi janë me interes për strukturën përkatëse policore, përfshirë nivelin drejtues dhe atë operativ. “IPK-ja në kuadër të raportit ka dhënë gjashtë rekomandime, që kanë të bëjnë me shtimin e aktiviteteve patrulluese në akset që shfaqin vështirësi në qarkullimin rrugor në kryeqytet, adresimin e parkingjeve të parregullta në

vendet e ndaluara, përmirësimin e cilësisë së logut operacional, shkurtimin maksimal të kohës së reagimit të njësive patrulluese, reagimin e shpejtë për të gjitha thirrjet e pranuar dhe shtimin e patrullimeve me automjete në zonat e përgjegjësisë së stacioneve”, ka njoftuar IPK-ja. Më tej thuhet se inspektimi është realizuar me kërkesë të kryeshefit ekzekutiv të IPK-së

dhe është përqendruar në stacionet policore të Prishtinës (Qendër, Jugu dhe Veriu), si dhe Njësinë e Trafikut për kryeqytetin, në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore të Prishtinës. “Inspektimi ka qenë me interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse stacionet dhe njësitë përkatëse të trafikut janë duke realizuar me sukses objektivat për të siguruar rrjedhë

normale dhe të sigurt të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve në kryeqytet. Gjithashtu, inspektimi ka ofruar një mundësi për t’u njohur me performancën e këtyre njësive policore në fushën e trafikut rrugor. Gjetjet e këtij inspektimi janë me interes për strukturën përkatëse policore, përfshirë nivelin drejtues dhe atë operativ”, ka njoftuar IKP-ja.

Kryeprokurori i Shtetit ofron mbështetje për luftimin e veprimtarive ilegale të shërbimeve të internetit dhe TV kanaleve

Prishtinë, 9 janar - Ushtruesi i detyrës ë Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e operatorëve të shërbimeve elektronike dhe Këshillit të Pavarur të Medieve (KPM). Temë e diskutimeve të përbashkëta ishte parandalimi dhe luftimi i veprimeve të operatorëve

ilegalë, të cilët, në mënyrë të kundërligjshme dhe përmes ndërhyrjes së paautorizuar, janë duke ofruar shërbime ilegale të internetit dhe TV kanaleve brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit që përfaqëson

për trajtim të shpejtë dhe profesional të rasteve që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, si dhe ka kërkuar mbështetjen e të gjithë operatorëve të licencuar që të bashkëpunojnë me prokurorinë për identifikimin e të gjitha veprimtarive ilegale, për çka operatorët janë zotuar se do të ofrojnë një mbështetje të tillë.



Në Obiliq arrestohet një person për dhunë në familje, i sekuestrohen edhe armë zjarri



OBILIQ, 9 JANAR - Në kuadër të veprimeve operative që po kryejnë zyrtarët policorë të rajonit të Prishtinës, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e veprave kriminale, nga zyrtarët e stacionit policor të Obiliqit është arrestuar një person i dyshuar për dhunë në familje

dhe armëmbajtje pa leje. Arrestimi është realizuar mbrëmë pas raportimit të një rasti të dhunës në familje. Personit të dyshuar i janë gjetur dhe sekuestruar dy armë zjarri. Ndaj personit të dyshuar B. E., mashkull 41 vjeç, në

konsultim me prokurorin e shtetit, është iniciuar rast për veprat dhunë në familje dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Personi i arrestuar, me vendim të prokurorit të shtetit, është dërguar në qendër të mbajtjes.

Tërnavë, pjesë e konferencës për shërbimet e Haxhit dhe Umres

PRISHTINË, 9 JANAR - Në Xhide të Arabisë Saudite ka filluar punimet Konferenca dhe Panairi për shërbimet e Haxhit dhe Umres. Në këtë konferencë, me ftesë të ministrit të Haxhit dhe Umres, dr. Tevfik Rabiah, po merr pjesë edhe delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, i kryesuar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë. Konferenca u hap nga zëvendësemiri i rajonit të Mekës, princi Saud bin Mishal. Në fjalën e tij hapëse, ministri saudit i Haxhit dhe Umres, dr. Tevfik Rabiah, theksoi se janë nisur projekte për zhvillimin e

infrastrukturës për vendet e shenjta në vlerë më shumë se pesë miliardë rialë (rreth 1.3 miliardë dollarë). Në këtë Konferencë po marrin pjesë ministra, krerë të institucioneve përgjegjëse për organizimin e haxhit nga më shumë se 80 vende. Konferenca do t'i vazhdojë punimet deri më 11 janar dhe përgjatë zhvillimit të saj do të diskutojë për iniciativat e shquara, produktet, shërbimet, projektet dhe investimet në teknologjinë inovative në sektorin e Haxhit dhe Umres.



KMDLNj përkrah hapjen e rrugës “Xhorxh Bush”



PRISHTINË, 9 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një komunikate për medie ka bërë me dije se është pro hapjes së rrugës “Xhorxh Bush” në kryeqytet e cila është bllokuar nga komuna. “Kur komuna e Prishtinës filloi të mbyllë rrugë të caktuara duke eksperimentuar se në cilin segment ‘është ndotja më e madhe e ajrit për shkak të fluksit të veturave’, dhe shih rastësinë pikërisht rruga që pastaj u mbyllë doli të jetë më e ndotura,

KMDLNj pati reaguar duke e cilësuar si shkelje e të drejtave të njeriut përkatësisht si kufizim të lirisë së lëvizjes. Edhe trafiku, në vend se të shkarkohet u shndërrua në lëmsh për shoferët dhe udhëtarët. Edhe bizneset janë dëmtuar me këtë mbyllje. Me një fjalë trafiku u shndërrua në kolaps. Tash, për ta formalizuar vdekjen klinike të trafikut, Komuna e Prishtinës ka paralajmëruar mbyllje të rrugës deri te Sheshi i Flamurit. Për KMDLNj kjo nuk paraqet asnjë zgjidhje përveç vazhdimit të

kaosit të trafikut urban. Rrugët e mbyllura Komuna e Prishtinës i ka shndërruar në hapësira korruptive të biznesit duke dëmtuar maksimalisht bizneset tjera. KMDLNj përkrah protestën e qytetarëve për hapje të rrugës ‘Xhorxh Bush’ dhe kundërshton çdo mbyllje të rrugëve tjera. Komuna e Prishtinës duhet ta marrë pëlqimin e banorëve për këto veprime dhe jo ta dhunojë vullnetin e tyre dhe lirinë e lëvizjes”, është theksuar në komunikatën për medie të KMDLNj-së.

Përparim Rama thotë se po ndodhin investime në Stacionin e Autobusëve



PRISHTINË, 9 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar ndërmarrjen publike të kryeqytetit, Stacionin e Autobusëve në Prishtinë. Rama ka bërë me dije se aty pa nga afër përpjekjet dhe investimet që janë duke u bërë për ta përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe

shërbimet e ofruara. “Edhe këtë vit vazhdojmë me super investime, të cilat përfshijnë modernizimin e hapësirave, përmirësimin e sistemit të informacionit për udhëtarët dhe zbatimin e teknologjive të reja për një qëndrim më të rehatshëm dhe të sigurt për të gjithë vizitorët”, ka thënë Rama.

Ai ka shtuar se projekti i madh për krijimin e Terminalit të Ri do të paraqitet në konferencën e investitorëve, e cila do të mbahet këtë fillimvit. “Po punojmë me shumë përkushtim që t'i rritim standardet e transportit publik dhe kontribuojnë në një qytet më të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm”, ka theksuar Rama.

Puna e qeverisë në Rahovec, Latifi mban mbledhje me drejtorët e drejtorive komunale

Rahovec, 9 janar - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smail Latifi, ka mbajtur mbledhjen e rregullt javore me drejtorët e drejtorive komunale, me të

cilët ka diskutuar për një varg çështjesh të angazhimeve ditore, planeve të mëtejme në secilin sektor të komunës, raportet për punën javore, si

dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar. Komuna e Rahovecit ka njoftuar se këto takime kanë për qëllim bashkëpunimin dhe

ndërveprimin ndërmjet drejtorive, duke ndihmuar në koordinimin e përpjekjeve për t'u avancuar më tutje.



Për shkak të ‘pagave të vogla’, mësuesit shfrytëzojnë pushimet pa pagesë për emigrim

PRISHTINË, 9 JANAR - Pushimet mjekësore dhe ato pa pagesë janë bërë një mënyrë për mësime të Kosovës për ta testuar shpërnguljen në vende evropiane duke mos e rrezikuar vendin e punës në Kosovë. Zyrtarët dhe sindikalistët arsimorë thonë se ky fenomen mund të popullarizohet edhe më shumë pas liberalizimit të vizave për Kosovën. Me një dashuri të madhe për ngjyrat, diplomë master në pikturë dhe 16 vjet përvojë pune si mësime në komunën e Drenasit në Kosovë, Bekim Istogu u largua për ta nisur një jetë të re në Gjermani. Ani pse e donte shumë profesionin e tij, Istogut i ishte mbushur mendja për ta lënë këtë karrierë në fillim të vitit 2022. Shkak për këtë ishte paga e ulët që merrte në atë kohë, rreth 420 euro në muaj, dhe që kishte rrezik t’i ulej edhe më tej pasi iu zvogëlua numri i orëve. “...Duhet të jenë 20 orë në javë për ta marrë një rrogë [të plotë] sa e merrnim atëherë. Rashë në 15, [u bë] një rrogë shumë e vogël”, thotë Istogu për Radion Evropa e Lirë. Në vitet e fundit Kosova është përballur në vazhdimësi me rënie të numrit të nxënësve duke krijuar në disa vende edhe tepicë të mësimeve. Para se ta linte punën, Bekimi punonte në tri shkollë të ndryshme në fshatra të Drenasit për ta arritur numrin e nevojshëm të orëve mësimore. “Në tri shkollë të udhëtoja, më shkonte rroga në naftë më shumë”, kujton ai. Si zgjidhje ai e pa një kompani të familjarëve të tij në Gjermani që merrte me dizajnim të hapësirave të brendshme dhe të jashtme të ndërtesave. Atij iu bë kontrata për të punuar si ekspert në përzgjedhje të ngjyrave dhe arriti të marrë vizë pune si profesionist i certifikuar. “E kam nostrifikuar diplomën, më është bërë njohja e diplomës dhe kam shkruar direkt në Ambasadë [të Gjermanisë] kam aplikuar dhe brenda dy javësh më është bërë viza”, thotë ai. Përveç procedurave për migrim, Bekimi i duhej kohë edhe për ta testuar nëse jeta dhe puna e re në Gjermani do t’i përshtatej. Ai deshi ta bënte këtë duke mos e rrezikuar menjëherë punën që e kishte në Kosovë. “Unë, realisht, e kam marrë një pushim mjekësor dhe kam ardhur direkt këtu, e pashë që ia vlente të rrija dhe... e kam thirrur drejtorin dhe i kam thënë që vendi im [i punës] të lirohet”, thotë Bekimi. Ai tregon se e mori pushimin njëvjeçar pa pagesë me arsyetim shëndetësor, por thotë se nuk i kujtohet se sa kohë pas marrjes së këtij pushimi e njoftoi punëdhënësin se nuk do të kthehej më. Rreth një vit e gjysmë pas migrimit të tij, Istogut iu bashkua në Gjermani edhe familja e tij - bashkëshortja me dy djemtë,



Kur lejohet marrja e pushimeve pa pagesë?

Puna e mësimeve në Kosovë rregullohet me Ligjin për Zyrtarët Publikë, ndërsa orari i punës dhe pushimet e tyre rregullohen me Ligjin e Punës. Ligji i Punës përcakton disa raste kur punëtorëve u lejohet marrja e pushimit pa pagesë për periudhë deri njëvjeçare. Këto raste përfshijnë ngritje në karrierë, shërbim jashtë vendit dhe përfshirja në raste gjyqësore. Pushimi mjekësor, në anën tjetër, mund të merret me pagesë deri në disa muaj dhe deri në një vit pa pagesë.

njëri 12 e tjetri 4 vjeç. Edhe bashkëshortja e tij punonte edukatore me fëmijët e nivelit parafillor në Drenas. Ajo, siç thotë Istogu, nuk mori pushim mjekësor, por vetëm e la punën për t’iu bashkuar në Gjermani. “Vështirë ka qenë t’ia dalim [në Kosovë], për shembull ta mendojmë më gjatë të ardhmen. Duke u rritur fëmijët, duhet shkollimi, veshmbathja e të tjera”, thotë ai. Bekimi - i cili në vitin 2018 kishte marrë mirënjohje në nivel komunal në Drenas si mësime i dalluar - thotë se shtysë e madhe për migrim ka qenë edhe mungesa e sigurimeve shëndetësore publike në Kosovë.

Pushimet, metodë e shpeshtë emigrimi për mësime

Bekimi thotë se në kohën e emigrimit të tij nuk ishte i vetmi që e kishte përdorur metodën e shfrytëzimit të pushimit për të dalë jashtë vendit. Këtë fenomen e ka ngritur si shqetësim edhe Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë në Kosovë. Rrahman Jasharaj, kryetar i kësaj sindikate, thotë se kanë informacione jozyrtare se numri i punëtorëve të arsimit në Kosovë që kanë bërë kërkesa për pushim

njëvjeçar arrin deri në 300. “Me siguri një pjesë e tyre kanë angazhime të tjera, por ekziston frika te ne se një pjesë e madhe prej tyre mund ta provojnë fatin jashtë vendit apo në sektorë të tjerë brenda në Kosovë. Dhe, po e gjetën veten, ata nuk do t’i kthehen sistemit arsimor”, thotë Jasharaj. Në Kosovë qeveritë lokale nëpër komuna janë punëdhënësit zyrtarë të mësimeve dhe drejtoritë komunale të arsimit merren me rekrutimin dhe aprovimin e pushimeve të mësimeve. Radio Evropa e Lirë ka dërguar kërkesa për informacione nëpër të gjitha komunat, por një pjesë e madhe nuk i janë përgjigjur kësaj kërkesë. Në komunën e Drenasit, sipas të dhënave zyrtare, vetëm gjatë vitit 2023, 16 mësime dhe punëtorë të tjerë të arsimit kanë kërkuar pushime pa pagesë me kohëzgjatje nga një muaj e deri në një vit. Ndërkohë, në Podujevë dhe Dragash janë dhënë nga pesë pushime.

“Ndryshe thonë me gojë e ndryshe me shkrim”

Gjatë vitit 2023 Besnik Hulajt, drejtor i arsimit në Komunën e Deçanit, i erdhën në tavolinë gjashtë kërkesa për pushim pa

pagesë. Arsyetimi zyrtar ishte për ngritje në karrierë. Por, sipas Hulajt, mësime nuk mund ta dëshmonin mjaftueshëm këtë arsyetim andaj kërkesat iu refuzuan. Hulajt thotë se arsyeja e vërtetë e tyre ishte emigrimi. “Ndryshe thonë me gojë e ndryshe me shkrim... Pra, arsyeja ishte emigrimi, sepse ky është vend i vogël dhe ne njihemi mes vete... por e binin një arsye që po shkojmë të ngrihem në karrierë”, tregon ai. Disa mësime në kësaj komune, sipas Hulajt, megjithatë gjetën një metodë tjetër për ta testuar emigrimin. “Ka pasur raste që kanë marrë tre muaj pushim mjekësor dhe nuk janë kthyer më. Pastaj, nga një letër e kanë dërguar te drejtori i shkollës dhe më pas drejtori i shkollës e dërgon te ne kërkesën për hapjen e vendit të lirë të punës”, shpjegon Hulajt. Sipas Hulajt, kjo metodë është edhe më shqetësuese. Ai thotë se duhet bërë hetim të përgjithshëm të vërtetësisë së pushimeve mjekësore që jepen nga mjekët në Kosovë. “Nëse një mjek ia lejon një mësime tre muaj pushim ose 21 ditë pushim mjekësor e mësime nuk është i sëmurë fare, duhen marrë masa edhe ndaj mjekëve. Ne nuk jemi ekspertë të hetojmë në spitale. Ne bazohemi në letra [dokumente]”, thotë ai. Radio Evropa e Lirë ka kërkuar të dhëna nga Inspektorati Shëndetësor se a ka hetime apo masa disiplinore ndaj stafit shëndetësor në Kosovë për keqpërdorime të tilla, por nuk ka marrë përgjigje deri në publikimin e artikullit.

A mund të përkeqësohet fenomeni?

Sipas Besnik Hulajt, problemi i parë që paraqitet pas largimit të një mësime në këtë formë

është vonesa në rekrutim. “Kemi pasur shumë probleme e ngecje sepse, për shembull, na vononte një muaj një rekrutim që ta bëjmë në bazë të procedurave”, thotë ai. Sipas tij, mundësia më e lehtë e udhëtimit pas liberalizimit të vizave për Kosovën në vitin 2024 mund ta rrisë edhe më shumë numrin e mësimeve që migrojnë në këtë formë. “Pushim vjetor e kanë një muaj, gjithçka mund të bëjnë, sepse kushtet ekonomike e bëjnë të veten”, thotë ai. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2022 nga Kosova u larguan rreth 41 500 banorë. Ky numër ka ndjekur një trend rritjeje në vitet e fundit - përveç në vitin 2020, kur udhëtimet ishin kufizuar shkaku i pandemisë Covid-19. Ndër arsyet e cekura për emigrim nga Kosova ka qenë edhe punësimi. Me Ligjin e ri për Zyrtarët Publikë, që hyri në fuqi në shkurt të vitit 2023, mësimeve iu rritën pagat. Varësisht nga niveli arsimor ku punojnë dhe nga përvoja e punës, ata paguheshin nga 580 deri në 610 euro. Rritja e pagave, sipas kryesindikalistit Jasharaj, ishte “e vogël dhe nënçmuese”. “Ata kanë pritur shumë më tepër”, thotë Jasharaj, i cili mendon që kushtet e vështira ekonomike të mësimeve do t’i shtyjnë ata edhe më tej drejt migrimit. “Kemi frikë se mund të shtohet [si fenomen], sepse komunikojnë kolegu me koleg dhe po shkuan një pjesë e madhe jashtë dhe po u stabilizuan atje, kemi frikë që rrugën e tyre mund ta vazhdojnë edhe të tjerë dhe gradualisht mund të hetohet edhe mungesa e stafit arsimor”, thotë Jasharaj. Paga mesatare në Kosovë është 520 euro. Ndërsa në vitet e fundit, shkaku i pandemisë Covid-19 dhe luftës në Ukrainë, çmimet për shumë produkte dhe shërbime janë rritur dukshëm.

Murati: Në vitin 2023 investimet kapitale janë rritur për 32 për qind

PRISHTINË, 9 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se, sipas raportit preliminar të shpenzimit të buxhetit, në vitin 2023 shpenzimet janë rritur për 13 për qind më shumë krahasuar me vitin 2022.

Murati ka thënë se kategoria që është rritur më së shumti në vitin 2023 është ajo e investimeve kapitale, 32 për qind më shumë se në vitin

2022. “Kategoria paga dhe shtesa është e dyta me kontributin më të madh në rritjen e buxhetit, me 114 milionë euro më shumë, apo 17 për qind më shumë sesa viti 2022. Kjo tregon se në sektorin publik ka pasur rritje mesatare të pagave që ka tejkaluar shkallën mesatare të inflacionit prej 11.6-përqindësh të vitit 2022. Mallrat dhe shërbimet,

gjithashtu me 17 për qind kanë trendin e njëjtë të rritjes, mirëpo si vlerë absolute rritja është përgjysmë më pak sesa kategoria paga dhe shtesa”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Më tutje ai ka thënë se kategoria me më së paku rritje në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, me vetëm 1 për qind.



Pritet rritje e çmimet të banesave në Kosovë

PRISHTINË, 9 JANAR - Çmimet në sektorin e patundshmërisë gjatë vitit 2023 kanë shënuar rritje, e cila pritet të përcillet edhe gjatë këtij viti.

Pronari i një agjencie për patundshmëri në vend, i cili merret me patundshmëri, qiradhënie dhe shitblerje, Dukagjin Avdyli, thotë për “KosovaPress” se edhe vitin që shkoj kishte rritje të çmimeve, ndërsa shprehet se rritje do të ketë edhe gjatë këtij viti për shkak se trendi është në rritje.

Avdyli thotë se për rritjen e çmimeve kanë ndikuar faktorë të ndryshëm. Një ndër ta është rritja e pagave të fuqisë punëtore në ndërtim. “Nëse e marrim historikisht në kohështrirje prej 10-12 që përcjell unë, gjithmonë çmimet kanë shkuar duke u shtrenjtuar. Mirëpo prej pandemisë dhe pas



luftës në Ukrainë, çmimet janë rritur në mënyrë drastike. Për shembull, rreth vitit 2013 në Fushë-Kosovë ka qenë çmimi rreth 450 euro për metër katror, në 2020 mbi 500 euro, pastaj pas luftës në Ukrainë në 600 euro, sivjet ka shkuar në 700 deri në 800 euro për metër katror në Fushë-Kosovë, për shkak se çmimet janë rritur në çdo sferë të jetës, por edhe për shkak të punëtorëve. Nëse një punëtor i ndërtimtarisë më herët ka marrë 600 euro pagë, sot i merr 800 deri në 1 000 euro”, ka thënë Avdyli.

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për tremujorin e dytë 2023, sektori i patundshmërisë mbulon 60 për qind të Investimeve të Huaja Direkte apo 110.6 milionë euro për periudhën prill - qershor 2023.

Pse po protestojnë bujqit në Gjermani?

BERLIN, 9 JANAR - Bujqit në Gjermani kanë filluar protestat, duke shkaktuar pasoja të rënda në qarkullimin rrugor në të gjithë territorin e federatës. Ata kanë theksuar se gjatë ditëve në vazhdim duan t'i bllokojnë hyrjet në autostrada dhe me kolonat e traktorëve që lëvizin ngadalë duan të hyjnë edhe në qendrat e qyteteve duke paralizuar lëvizjen. Në shumë zona bllokada ka nisur të hënën në mëngjes dhe ka vazhduar edhe të martën. Në Berlin u mblodhën qindra bujq me traktorët e tyre në manifestimin qendror përpara portës së Brandenburgut. Në lande të tjera si në Bavari, Brandenburg dhe Renaninë Veriore - Vestfalinë pjesërisht ka pasur edhe “pengesa masive në trafik”, sipas njoftimeve të policisë. Akset kryesore rrugore u bllokuan, nëpër rrugë mund të qarkullohej vetëm në një korsi. Protestat do të vazhdojnë deri më 15 janar me një



manifestim masiv në Berlin. Bujqit po protestojnë kundër politikës së kursimeve të qeverisë. Masat e kursimeve u bënë të

domosdoshme pas debatit të ndezur për buxhetin si rrjedhojë e një vendimi të Gjykatës Kushtuese lidhur me buxhetin e

vitit 2023. Fillimisht në planet buxhetore ishte parashikuar një favorizim tatimi për automjetet e

bujqve dhe pylltarëve. Pas vështirësive të krijuara me vendimin mbi buxhetin 2024, qeveria mendoi ta pezullojë menjëherë këtë favor, për të siguruar në buxhet një shumë prej gati një miliard eurosh.

Qysh në dhjetor të vitit 2023 bujqit protestuan kundër tërheqjes së masës së parashikuar favorizuese nga qeveria. Aktualisht planet parashikojnë që favorizimi në tatim për karburantin për automjetet e kësaj kategorie të vlejë për një periudhë trevjeçare. Duke nisur nga viti 2027 të mos ketë më mbështetje financiare për karburantin. Sipas ministrit të Bujqësisë, një ndërmarrje e mesme apo e madhe bujqësore për vitin 2024 mund të llogarisë rreth 1 000 euro më shumë shpenzime për naftën. Çlirimi prej tatimit për naftën duhet të vazhdojë të mbetet në fuqi pa afat.

MINT anulon tenderin për rezervën shtetërore, u tejkalua buxheti i planifikuar

PRISHTINË, 9 JANAR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka anuluar tenderin për furnizim për produktet e nevojshme për rezervën shtetërore. Sipas


arsyetimit, ofertuesit e kishin tejkaluar buxhetin e planifikuar të kësaj ministrie. Kështu thuhet në dokumentin e publikuar nga ana e Komisionit Rregullativ të

Prokurimit Publik. Oferta ishte përgatitur për 80 mijë kilogramë oriz, 65 mijë litra vaj ushqimor, 80 mijë copë nga 200 gramë conserva (risk gjedhi) dhe 15 mijë bidona ujë

dhjetëlitërshe. Vlera e tenderit kap shumën e 227 mijë e 500 eurove, ndërsa ofertat për sasinë dhe produktet në ofertë në vlerë 238 mijë euro dhe 317 mijë euro.



Në kërkim të Ekuacionit të Zotit



Edhe me një smartphone dhe Google në majë të gishtave, disa gjëra janë thjesht të vështira për t'u rrokur nga truri juaj. Merrni, për shembull, idenë në dukje të pamundur që energjia nuk rrjedh vazhdimisht, por lëshohet në paketa të quajtura kuante. Apo idenë që tërësia e kozmosit, e cila përfshin rreth 93 miliardë vite dritë, mund të jetë vetëm njëri, në një mori universesh paralele.

Pikërisht këtu hyn Michio Kaku. Fizikani ka ndërtuar një karrierë të fuqishme si një popullarizues i shkencës në tregun masiv, duke zgjidhur disa nga konceptet më të ndërlikuara të fizikës dhe duke i përmirësuar ato për publikun. Libri i tij i fundit, “Ekuacioni i Zotit”, përshkruan përpjekjen e gjatë për të krijuar një “teori të gjithçkasë” që do të kombinonte modelin e relativitetit të përgjithshëm të Ajnshtajnit me teorinë kuantike, dhe potencialisht do të zhbllokonte kuptime të reja të hapësirës dhe kohës.

Kaku flet rreth asaj që e magjepste kur ishte fëmijë, pse grimcat nënatomike janë si shënime në një varg vibruës dhe çfarë mund të mësojmë nga fantashkenca.

Në librin tuaj ju flisni për në teori gjithëpërfshirëse të gjithçkasë, që e shihni si gralin

e shenjtë të Fizikës. Pse është kaq e rëndësishme një teori e tillë?

Kur Njutoni përpunoi ligjet e gravitetit dhe të mekanikës, ai vuri në lëvizje atë që përfundimisht u bë Revolucioni Industrial, i cili e nxori njerëzimin nga mjerimi dhe varfëria agrare. Kur Maksuelli dhe Faradei përpunuan ligjet e elektricitetit dhe magnetizmit, ata vunë në lëvizje Revolucionin Elektrik, i cili na dha energjinë elektrike, radion, TV, dinamon dhe gjeneratorët. Kur Heisenberg dhe Schrödinger përpunuan ligjet e kuantit dhe atomit, që na dhanë lazerin, transistorët, kompjuterët dhe internetin. Pra, sa herë që fizikanët shpjegojnë një forcë të natyrës, ajo ndryshon fatin e racës njerëzore dhe ekonomisë botërore.

Dhe tani, jemi në prag të një teorie të gjithçkasë, e cila mund të bashkojë të gjitha forcat e universit nëpërmjet një ekuacioni ndoshta jo më shumë se 2.5 cm të gjatë. Përfundimisht, kjo mund të ndryshojë edhe një herë fatin e njerëzimit.

Mund t'u përgjigjet gjithashtu pyetjeve më të thella rreth universit, si p.sh.: A mund ta thyejmë barrierën e dritës dhe të arrijmë yjet? Çfarë ndodhi para Big Bengut? A ka universe dhe dimensione të tjera? A

është i mundur udhëtimi në kohë?

Kërkimi për këtë teori ka magjepsur disa nga shkencëtarët më të famshëm të historisë. Çfarë pati tek kjo teori e gjithçkasë, që ndezi fillimisht imagjinatën tuaj?

Kur isha 8 vjeç, ndodhi diçka që më ndryshoi jetën. Të gjitha gazetatat thoshin se një shkencëtar i madh sapo kishte vdekur. Por ata printuan një foto të tavolinës së tij, me një libër të hapur. Me kalimin e viteve, zbulova se emri i këtij njeriu ishte Albert Einstein dhe se ky libër ishte teoria e papërfunduar e unifikuar e fushës, e cila mund të bashkonte të gjitha ligjet e natyrës në një ekuacion të vetëm. Më duhej të dija se çfarë kishte në atë libër dhe pse ai nuk mundi ta përfundonte. Ky u bë fokusi i jetës sime.

Sot, kandidati kryesor (dhe i vetmi) për këtë teori të gjithçkasë quhet teoria e fijeve. Unë kam pasur privilegjin të punoj mbi këtë teori që nga viti 1968. Kontributi im ishte — së bashku me profesorin Keiji Kikkawa — për të krijuar teorinë e fushës së vargut, e cila mund ta përmbledhë teorinë e fijeve në një ekuacion rreth 2.5 cm të gjatë. Megjithatë, nuk është teoria përfundimtare, pasi tani e dimë se membranat mund të ekzistojnë së bashku me vargun.

Si do ta përshkruanit ju, Teorinë e Fijeve?

Për të kuptuar teorinë e fijeve, imagjinoni një llastik, i cili përfaqëson një elektron të vogël fare. Nëse e shtrini llastikun, ai dridhet në një frekuencë të saktë. Nëse e lëvizni, ai vibron në një frekuencë të ndryshme — quajeni atë një neutrino. Nëse e tundni përsëri, bëhet një frekuencë tjetër; quajeni atë një kuark. Në fakt, ekziston një numër i pakufizuar frekuencash në të cilat llastiku mund të vibrojë, që korrespondon me një numër të pafund grimcash të mundshme nënatomike.

Pra, të gjitha grimcat nënatomike të natyrës janë si nota muzikore në një varg të vogël vibruës. Thelbi i kësaj ideje u propozua mbi 2000 vjet më parë nga matematikani i madh Pitagora. Ai kuptoi se një tel i lirës (vegla muzikore) mund të dridhet me një numër të pafund notash muzikore, secila prej të cilave korrespondon me një frekuencë rezonance. Më pas ai propozoi se diversiteti i madh i materies që shohim rreth nesh nuk është gjë tjetër veçse harmonitë që gjenden në tela. Vetëm muzika, mendoi ai, ishte mjaft e pasur për të kuptuar kompleksitetin e madh të universit.

Libri juaj “Fizika e të


pamundurës” eksploron besueshmërinë e koncepteve të ndryshme fantastiko-shkencore, si fushat e forcës, hiperhapësira dhe udhëtimi në kohë. Tani po jepni mësim në një kurs për fizikën e fantashkencës. Pse jeni tërhequr nga këto koncepte?

Kur isha 8 vjeç, të shtunën në mëngjes, shikoja serialin e vjetër Flash Gordon. Armë me rreze. Qytete në qiell. Rrezet e padukshme. Qytetet nën oqeane. Unë isha i magjepsur. Vite më vonë, kuptova se dy dashuritë e mia, teoria e unifikuar e fushës së Ajnshtajnit dhe fantashkenca, ishin të lidhura mes tyre. Për të kuptuar nëse fantashkenca është e mundur, e besueshme apo e pamundur, ju duhet fizika. Shkoja në filma fantastiko-shkencorë dhe numëroja ligjet e fizikës që shkeleshin.

A keni një teknologji apo koncept të preferuar të fantashkencës?

Romanet e mia të preferuara të fantashkencës, janë seria “Themeli” e Asimovit, sepse ato të detyrojnë të imagjinosh një qytetërim galaktik 50 000 vjet në të ardhmen, ku shpalosen ligje të reja të fizikës. Gjërat që ne i mendojmë të pamundura, mund të bëhen të mundura. Gjithçka mund të ndodhë.

| *Discover – Bota.al*



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gazeta kroate i thur lavde Hoxhës: Është profesionist, luftëtar, Dinamo nuk ka prej kohësh një si ai

ZAGREB, 9 JANAR - Arbër Hoxha ka bërë hapin e madh në karrierë dhe brenda ditësh, ose orësh, pritet të jetë zyrtarisht futbollist i Dinamos së Zagrebit. Ish-futbollisti i Prishtinës e Ballkanit ka kaluar nga Sllaven Belupo te gjiganti kroat në një marrëveshje që kap shifrën e dy milionë eurove, raportuan mediet kroate të hënën. Gazeta kroate "Jutarnji List" e cilëson Hoxhën xhevahir të ligës kroate.

Tek Arbër Hoxha Dinamo do të marrë përforsimin që nuk e ka prej kohësh. "Ai është një lojtar që trajneri i bluve Sergej Jakiroviq e donte në dhomën e tij të zhveshjes për disa arsye dhe, ndoshta, më e rëndësishmja, është se ky kosovar i lindur në Gjermani mund ta bëjë dallimin menjëherë në krahun e majtë", shkruan gazeta. Hoxha ka kohë që është në formë të mirë dhe, siç shkruan "Jutarnji List", ai është një profesionist i jashtëzakonshëm, kujdeset për veten dhe trupin e tij, i është përkushtuar plotësisht futbollit dhe nuk është i prirë për lëndime. "Ai tërhoqi vëmendjen me cilësitë e tij që rrallëherë i gjejmë 'në paketim'. Hoxha ka shpejtësinë e nevojshme për një anësor, është në gjendje të driblojë pothuajse çdo lojtar kundërshtar në situata ballë për ballë dhe karakterizohet nga një goditje e fuqishme dhe e saktë", shkruan "Jutarnji List". Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ai nuk është i panevojshëm as në fazën e mbrojtjes. Hoxha i kryen pa diskutim të gjitha detyrat në mbrojtje, përcjell mbrojtësin kundërshtar dhe nëse është e nevojshme, mbulon edhe shokun e skuadrës në pozicionin e mbrojtësit të majtë. Gazeta kroate vijon duke shkruar se të gjitha këto tipare të Hoxhës mund t'u kujtojnë tifozëve të Dinamos heroin e tyre të periudhës së fundit, Mislav Orshiqin, i cili u largua janarin e vitit të kaluar për mbi 5 milionë euro te



Southamptoni, asokohe në Premierë Ligë. "Natyrish ne nuk pretendojmë se Hoxha është 'pasardhësi i Orshiqit'. Ai do të duhet të tregojë shumë për ta merituar këtë pseudonim, por gjithsesi ai ka potencial të madh që do të dalë edhe më shumë në pah në një skuadër më të mirë sesa Slloveni", shkruan gazeta.

Duke qenë se është 25 vjeç, Hoxha ka potencial për një transferim nga Dinamo jashtë Kroacisë, por në këtë moment më e rëndësishmja për 24-herë kampionët e Kroacisë është se

ata e kanë forcuar sulmin me një lojtar që mund të luajë menjëherë. Ai e njeh ligën dhe është në formë. Ndoshta nuk do t'i duhet shumë një periudhë përshtatjeje, vijon shkrimi i "Jutarnji List". Si lojtar i Dinamos, Hoxha sigurisht se do të bëhet më interesant edhe në sytë e drejtuesve të kombëtares shqiptare, pasaportën e së cilës e ka marrë së fundmi, pikërisht për arsye futbollit. Nuk është e pamundur që Hoxha të luajë për Shqipërinë kundër Kroacisë në Kampionatin Evropian verën e ardhshme.

SHKURT

Millaku përforcon Drenicën

Skuadra e Drenicës është duke vazhduar përforsimet në këtë afat kalimtar. Pas Leart Eminit, klubi kuqezi nga Skenderaj zot e ka paraqitur edhe Met Millakun. Mesfushori nga Klina ka pasur paraqitje në Superligë me Dukagjinin dhe së fundmi me Feronikelin 74. "26-vjeçari do të jetë një forcë shtesë për ekipin në stinorin pranveror për ta ndihmuar skuadrën për t'i arritur objektivat. Drejtuesit e klubit po punojnë vazhdimisht të afrojnë edhe disa lojtarë të tjerë në mënyrë që të kompletohet skuadra për stinorin që nis me 17 shkurt", thuhet në njoftimin e skuadrës së Drenicës.

Sociedadi interesohet për Zhegrovën

Ylli i Kosovës, Edon Zhegrova, po kalon nëpër një formë fantastike në kampionatin francez. Ai mund të largohet gjatë verës nga Lille. Një propozim konkret për 24-vjeçarin vjen nga La Liga. Sipas "NotGip", ish-futbollisti i Baselit e do Real Sociedadin. Klubi spanjoll e sheh përfaqësuesin e Kosovës zëvendësues potencial të Chos. Mbetet të shihet nëse futbollisti do të jetë i interesuar të transferohet në Sociedad dhe nëse ky i fundit do ta bëjë ofertën e duhur për Zhegrovën. Lille e vlerëson lojtarin 17-20 milionë euro. Zhegrova ka kontratë me klubin nga Liga 1 deri në vitin 2026, por nuk përjashtohet mundësia që ai të largohet nga Franca gjatë verës që vjen.

Shefki Kuqi edhe zyrtarisht trajner i Feronikelit

Shefki Kuqi është emëruar edhe zyrtarisht trajner te Feronikeli 74. Kuqi emër i njohur për futbollin evropian si lojtar, ka lënë gjurmë te skuadrat Blackburn Rovers, Crystal Palace, Swansea City, Newcastle United. "Pas një karriere fantastike si futbollist, Kuqi vjen me idenë e tij për filozofinë e lojës të cilën mëton ta aplikojë te skuadra jonë. Ai ka krijuar mjaftueshëm bagazh edhe në shtabin teknik kryesisht në Finlandë, duke drejtuar edhe skuadra si Inter Turku", thuhet në njoftim e "Niklit". Pjesë e asistentëve të tij vazhdojnë të jenë Faruk Elshani dhe Avni Hasani, duke u shtuar edhe kualiteti i spanjollit Albert Ramos Morano, gjithashtu edhe Fidan Rexhepi.

Kosova me dy skitarë në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj 'Gangwon 2024'

PRISHTINË, 9 JANAR - Ekipi olimpiq i Kosovës do të përfaqësohet me dy skitarë në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj. Këto lojëra do të mbahen prej 19 janarit deri më 1 shkurt 2024 në qytetin Gangwon të Koresë së Jugut. Skitarët janë Lirika Deva dhe Klos Vokshi, të cilët do të

garojnë në disiplinat e skijimit alpin, sllalom dhe sllalom të madh. Të dy janë kualifikuar me normë olimpike. Me ekipin do të udhëtojnë edhe trajnerët Kushtrim Deva dhe Ernest Sefaj. Ndërsa shef i misionit është Bujar Turjaka. "Në LOD për të Rinj Gangwon 2024 marrin pjesë 1900

sportistë të moshës 15-18 vjeç. Kosova është njëra prej 79 vendeve pjesëmarrëse. Gangwon 2024 është edicioni i katërt i Lojërave Olimpike Dimërore për të Rinj, ndërsa për ekipin tonë është pjesëmarrja e dytë pas debutimit në Lozanë 2020", shkruan në kumtesë.



Khaka në mesin e top pesë mesfushorëve më të kompletuar në Evropë

LEVERKUSEN, 9 JANAR - Granit Xhaka është duke e kaluar një sezon fenomenal. Ylli nga Kosova e mori një vendim të papritur gjatë verës së shkuar duke e lënë Premierligën për Bundesligën. Sidoqoftë, tash po del se përfaqësuesi zviceran nuk ka gabuar me vendimin e tij për

t’iu bashkuar Bayer Leverkusenit. 31-vjeçari është bërë figurë kyçe e ekipit të trajnerit Xabi Alonso në një sezon sensacional që po e kalojnë “Farmaceutikët”. Faqja që merret me statistika të futbollit, “DataMB” e ka futur Xhakën në mesin e top pesëshja

mesfushorëve më të kompletuar në Evropë. Në këtë renditje janë llogaritur statistika të ndryshme, përfshirë këtu saktësia e pasimeve, dobia e pasimeve dhe në përgjithësi kontributi në fushën e blertë. Ish-futbollisti i Baselit dhe i Borussia Monchengladbachut i ka

grumbulluar 27.91 pikë duke e lënë prapa Toni Kroosin e Real Madridit, i cili e mbyll top pesëshen. Top treshja përbëhet nga Rodri, Palacios e Frenkie de Jong. Xhaka i ka zhvilluar 23 ndeshje me Leverkusenin në këtë sezon, ndërsa e ka bërë një asistim.



Formacioni i vitit 2023 nga IFFHS, dominon City

MANCHESTER, 9 JANAR - IFFHS Federata Ndërkombëtare e Historisë dhe Statistikave të Futbollit ka shpallur formacionin standard për vitin 2023, të përbërë nga lojtarët që kanë pasur performancën më të mirë. Manchester City dominon me pesë lojtarë, ndërsa mungesa befasuese e Cristiano Ronaldos, golashënuesit më të mirë të vitit kalendarik, i ka habitur të gjithë, edhe vetë atë. Në portë është Edersoni, i cili fitoi tripletën me Manchester Cityn e Guardiols, para tij si “pivot” mbrojtës Ruben Dias. Së bashku me portugezin u përzgjedhën edhe Kim Min-jae (Napoli/Bayern, përfaqësuesi i vetëm i Serisë A) dhe Alphonso Davies i Bayern Munichut. Në mesfushë bie në sy emri i Jude Bellinghamit, autor i një fillimi të bukur të sezonit me Real Madridin. Fenomeni anglez është në shoqërinë e Rodrit, shënues i golit vendimtar në finalen e Ligës së Kampionëve ndaj Interit dhe një tjetër lojtar i Cityt, Kevin de



Bruyne, i cili shfaqet në skuadrën ideale pavarësisht se ka mbi katër muaj që nuk luan. Më në fund mesfushorëve iu bashkua edhe Lionel Messi, disi me forcë, si nnderim për fitimin e “Topit të Artë” për herë të tetë. Në sulm është një treshe ëndrrash, e përbërë nga tre

lojtarët aktualisht më të fortë në botë: Harry Kane, forca lëvizëse e Anglisë dhe sulmuesi i ri i Bayernit, Erling Haaland, makineri e pamëshirshme e golashënuesve dhe Kylian Mbappe, objekt dëshire i merkatos në mbarë botën.

Surpriza në NBA, humbasin Milwaukee dhe Bostoni



MILWAUKEE, 9 JANAR - Bostoni ka pësuar humbje me rezultat 133-131 ndaj Indianas në një përballje mes ekipeve rivale në Konferencën e Lindjes. Gjithsesi, Celtics ruan kreun e renditjes në këtë kah të NBA-s. Browni realizoi 40 pikë për

Bostonin, që s’mjaftuan, ndërsa për Indianan 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Mathurin me 26 pikë më i miri). Clippersat rikthehen te fitorja pas humbjes në derbi, duke mposhtur me shifrat 138-111 Phoenixin. Vendimtar ishte stoli i

clippersave, nga ku erdhën 44 pikë, ndërsa 30 pikët e Durantit mbetën për statistikë. Pas kohës shtesë fiton Chicago, që mundi Charlotten (119-112), sfidë ku u dallua Coby White me 27 pikë. Befason skuadra e Utah Jazzit, që fitoi në fushën e Milwaukeees (132-116). Pesë lojtarë për miqtë realizuan mbi 19 pikë, duke bërë të pavlefshme “triple double” të Antetokounmpos (25 pikë, 10 rebounde, 11 asistime). Fiton Miami, që mundi 120-113 Houstonin, ndeshje ku u dallua Tyler Herro me 28 pikë.

REZULTATET	
Charlotte - Chicago	112-119
Indiana - Boston	133-131
Washington - Oklahoma	128-116
Miami - Houston	120-113
Milwaukee - Utah Jazz	116-132
Clippers - Phoenix	138-111

SHKURT

Cikalleshi mund të rikthehet në Arabinë Saudite

E ardhmja e Sokol Cikalleshit mund të jetë sërish Arabia Saudite. Oferta të shumta kanë ardhur në drejtimin e sulmuesit të Kombëtares kuqezi, ndër to edhe ish-skuadra Al-Khalej me të cilin luajti sezonin e kaluar. Tashmë drejtuesit e Konyasporit do ta lejojnë transferimin e futbollistit shqiptar sipas interesave të skuadrës. Ndërsa te skuadra turke në formë huazimi është transferuar sulmuesi Umut Najir. Ai luajti vetëm 118 minuta me Fenerbahçen dhe kontrata do të përfundojë më 30 qershor 2025. 30-vjeçari ka luajtur katër herë për kombëtaren dhe ka shënuar një gol.

Dy garat e para në Formula 1 do të zhvillohen të shtunën

Sezoni 2024 në Formula 1 nuk ka nisur ende, por që tani kanë nisur disa modifikime në kalendarin e garave. Kështu, gara e parë sezonale do të zhvillohet më 2 mars në Bahrein. Pra, ditën e shtunë. FIA (Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit) ka vendosur që dy garat e para sezonale të këtij viti të zhvillohen ditën e shtunë për shkak të muajit të Ramazanit. Ai nis më 10 mars. Për pasojë, është vendosur që gara e Bahreinit të zhvillohet me datën 2 mars. E njëjta gjë edhe me garën e dytë, që zhvillohet pas një jave në Arabi. Edhe kjo garë do të zhvillohet ditën e shtunë, pra më 9 mars. Këtë vit do të jenë tri garat që do të zhvillohen ditën e shtunë, gara e tretë është ajo e Las Vegasit që do të zhvillohet më 23 nëntor. Kjo garë zhvillohet ditën e shtunë me orën evropiane. Më pas do të garohet në Australi, më 24 mars (ditën e diel), që është gara e tretë sezonale e Formula 1.

Seria A përgatit reformën, nga 20 në 18 skuadra

Numri i lartë i ndeshjeve në një sezon po bëhet gjithnjë e më shqetësues për futbollistët, teksa ata vetë, por edhe trajnerët, nuk i kanë kursyer asnjëherë ankesat për impenjimet e shumta. Veçanërisht futbollistët e klubeve të mëdha janë ata që nuk i shpëtojnë asnjëherë intensitetit, duke luajtur në kompeticione të ndryshme, përfshirë edhe grumbullimet me përfaqësueset përkatëse. Pikërisht për këtë arsye, kreu i Federatës Italiane të Futbollit, Gabriele Gravina, ka hedhur idenë e një ndryshimi në Serinë A, që ka të bëjë me reduktimin e skuadrave pjesëmarrëse nga 20 në 18. Dy skuadra më pak, që do të përktheheshin në dy javë më pak në kalendarin sezonal të Serisë A, teksa propozimi mbështetet nga klubet e mëdha, por has në kundërshti nga ato të nivelit mesatar dhe të ulët. Në muajin mars është parashikuar të mblidhet edhe Asambleja e Jashtëzakonshme e Ligës së Serisë A, ku pritet të ketë edhe një debat të fortë pikërisht për numrin e skuadrave pjesëmarrëse në Serinë A. Rruga e parë është arrija e marrëveshjes për një kampionat me 18 skuadra, por kjo reformë kërkon konsensus të të gjithë ekipeve pjesëmarrëse. Nëse nuk do të ketë një marrëveshje, atëherë pritet që të synohet miratimi i një pike që i heq të drejtën e vetos një skuadre të vetme dhe bën që vendimet të miratohen me shumicë votash.

Bonucci ëndërron rikthimin në Serië A, afër marrëveshjes me Genoan

Leonardo Bonucci është në kërkim të një klubi të ri dhe pas dështimit të kalimit te Roma, tashmë italian i ka nisur kontaktet me një tjetër klub. Bëhet fjalë për

skuadrën e Genoas, me “Kuqebllutë”, me teknikun Alberto Gilardino, që pas shitjes së rumunit Radu Dragusin te “Londinezët” e Tottenhamit,

kërkon një mbrojtës të madh dhe duke llogaritur faktin që mbrojtësi veteran mund të rikthehet me parametra zero, shihet si opsion i përkryer pasi disponon cilësi dhe

përvojë të konsiderueshme për të ndihmuar një skuadër si “gjenovezët”, që objektiv primar ka mbijetesën në Serinë A. Kthimi në një formacion titullar është

synim i 36-vjeçarit, që ëndërron një ftesë nga tekniku i Kombëtares, Luciano Spalletti, për në Kampionatin Evropian të Gjermanisë “Euro 2024”.

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Njësi: -ADU- Nr. Prot.: 01/2024
Unit: Jednica: Prot. No.:
Nr. i faqeve: 02 Data: 09.01.2024
No. of pages: Datum:
Str. stranica: Prishtinë

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

SEKRETAR/E I/E PËRGJITHSHME I/E ODËS

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 01/2024

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Kryetarin dhe organet e tjera të OMK-së;
- Siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të organeve të OMK-së të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive;
- Siguron që masat zbatuese të Odës të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave;
- Lëshon urdhëresa dhe udhëzime për kryerjen e punëve me miratim të organeve të OMK-së;
- Menaxhon personelin e Shërbimit Profesional;
- Menaxhon rrjedhën e informacionit në OMK;
- Bashkëpunon me sekretarët e Odave tjera në baza të rregullta;
- Koordinon raportin e organeve të OMK-së me organet e saj vartëse administrative; dhe
- Kryen edhe punë të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesës së Kryetarit të OMK-së dhe Këshillit Drejtues të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Kryetari i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të jetë i diplomuar në ndonjërin nga degët e fakulteteve si: Mjekësi, Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo të avancuar (studime master të fushës e menaxhimit);
- Të ketë shkathësi në përcaktimin dhe arrijen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;
- Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune menaxheriale pas diplomimit;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën “Instituti A” QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **09/01/2024 deri më 24/01/2024, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300 apo 038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Njësi: ADU Nr. Prot.: 01/2024
Unit: Jednica: Prot. No.:
Nr. i faqeve: -02- Data: 09.01.2024
No. of pages: Datum:
Str. stranica: Prishtinë

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 04/2024

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlihen me vendimarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësit të Zyrës për Administrat dhe Financa

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të përfunduar fakultetin në fushat relevante, nivel bachelori;
- Një (1) vitë përvoj pune në administratë;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjues;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën “Instituti A” QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **09/01/2024 deri më 24/01/2024, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300 apo 038/544-872.**



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA
Njësia: ADH
Unit: ADH
Nr. Prot.: 02/2024
Br. Prot.: 02/2024
Data: 09.01.2024
Datum: 09.01.2024
Prishtinë

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

Zyrtar/e Ligjor/e

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 03/2024

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinone/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Ofron shërbime dhe këshilla profesionale për organet e OMK-së sipas kërkesës të organeve të OMK-së dhe me referencë të Kryetarit të Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMK-së;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të punëdhënësit në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësi i Zyres Ligjore

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të kryer Fakultetin Juridik, niveli master i studimeve konsiderohet përparësi;
- 3 (tre) vite përvojë pune në profesion;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Të jetë fleksibil/e dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- I/e aftë të mbajë informatat konfidenciale në mënyrë të përshtatshme;
- Personalitet të përkushtuar, me iniciativë, aftësi dhe vullnet për të marrë përgjegjësi;
- Shumë i/e mirë në punë ekipore dhe aftësi për të mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar të bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën “Instituti A” QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 09/01/2024 deri më 24/01/2024, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA
Njësia: ADH
Unit: ADH
Nr. Prot.: 02/2024
Br. Prot.: 02/2024
Data: 09.01.2024
Datum: 09.01.2024
Prishtinë

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ari Pharm” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811349605 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ari Pharm” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811349605 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Ari Pharm” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811349605 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shqipe Kameri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore “Pjetër Muçaj” në Guskë të komunës së Gjakovës nga klasa e -I- deri në klasën e -VIII-të.

- Elvis Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Adelina Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Ober Vehapi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Medreseja “Alauddin” Prishtinë.

- Agim Feka shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Eqrem Çabej” ish shkolla Mosha Pijada.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

